

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë, përmes gjyqtares Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.M. nga ..., K. e Kamenicës, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 parag.3 lidhur me parag. 2 e 1 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjilani, PP.nr.2128/2010, prej dt.24.11.2010, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datën 28.07.2015 komunikoi, ndërsa më dt.11.08.2015, përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

M.M. nga ... K.e Kamenicës, i padënuar më parë për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Më datën 30.09.2010, rreth orës 17.20 h, në fsh..., komuna e Kamenicës, i pandehuri nuk ka përfillur urdhrat e dhënë nga ana e njësitit policor për tu nisur për Kamenicë pasi që më parë i pandehuri ishte zënë në bartjen e paligjshme të drunjëve dhe nuk kishte poseduar dokumentacionin e rregullt në lidhje me drunjtë. I pandehuri jo vetëm që nuk ka përfillur urdhrin e policisë por i njëjti ka filluar edhe të fyejë pjesëtarët e policisë dhe ka kundërshtuar arrestimin e tij duke mos pranuar të hynte në veturën e policisë dhe duke goditur veturën me këmbë, duke penguar kështu personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të ruajtjes së rendit publik.

-me çka ka kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 parag. 3 lidhur me par. 2 e 1 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 41, 45, 47, 73, 75, 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin,

E g j y k o n

-Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë, ashtu që shumën e përgjithshme prej 600 € do ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në qoftë se dënimi me gjobë nuk do të paguhet atëherë do të ekzekutohet dënimi me burg.

-Gjykata në kuptim të nenit 47 të KPRK-së, të akuzuarit me pëlqimin e tij i mundëson që dënimin e shqiptuar me burg efektiv, ta paguaj me të holla, ashtu që çdo ditë burgu, do t'i llogaritet nga 20 Euro.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 € , në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi .

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Gjilan, me akuzën PP.nr.2128/2010, prej dt.24.11.2010, si në hyrje të aktgjykimit ka akuzuar M.M. nga f.sh. ..., K. e Kamenicës, për shkak të veprës penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 paragraf. 3 lidhur me par. 2 e 1 të KPK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin

I akuzuari M.M. gjatë mbrojtjes së tij nuk kontestoi faktin se në hyrje të fshatit është ndalur nga ana e policisë , ku të njëjtit kanë kërkuar dokumentacionin për drunjët të cilat ka qenë duke i bartur, në vend të ngjarjes ka dalur drejtori i ekonomisë së pyjeve dhe pas kontrollimit të dokumentacionit ka konstatuar se nuk është në rregulle, policët nuk kanë folur në gjuhën serbe, në vend të ngjarjes ka qenë polici A.P. dhe polici emrin e të cilit nuk ia di por e di se është nga fshati ... i cili e ka shtyrë në drejtim të veturës dhe ka filluar t'i bërtas, i ka nxjerr tabletat nga xhepi për ti pirë, mirëpo polici i ka thënë në gjuhën serbe se nuk më intereson se ti çka pinë, nuk pranon se ka fyer policin, policët A.P. dhe F.M. e kanë futur me forcë në veturë të policisë por nuk e kanë prangosur e kanë dërguar në stacion policor ku edhe ka dhënë deklaratë, pastaj ka shkuar tek mjeku dhe raportin mjekësor e ka dërguar te komandanti i stacionit policor në Kamenicë, ka pasur frikë të ankohet, komandanti ka kërkuar nga unë që të heshti për të mirën time dhe të familjes . Në fjalën përfundimtare i akuzuari nuk e ndien vetën fajtor për kryerjen e kësaj vepre penale dhe kërkon nga gjykata që ta liroj nga përgjegjësia penale lidhur me këtë vepër, po që se gjykata gjenë prova dhe më shqipton një dënim me burg atëherë dënimin me burg mundësisht të ma zëvendësoj në dënim me të holla .

Gjykata në procedurën provuese ka dëgjuar dëshmitarët dhe ka bërë shikimin dhe leximin e provave materiale bashkangjitur lëndës si: raportin e specialistit me nr. ... të datës ... i ...-së në ..., si dhe janë shikuar fotot në vend ngjarje.

Dëshmitari G. S. në dëshminë e tij ka deklaruar, është e vërtetë se policët e kanë ftuar, lidhur me dy traktora drunjë të cilët nuk kanë pasur dokumentacion të rregullt për të lëvizur në rrugë, ka dalur në vend të ngjarjes ka parë se traktorët në fjalë nuk ka pasur dokumentacion në rregull ka urdhëruar që drunjët të konfiskohen dhe të dërgohen në depon e ekonomisë së pyjeve, drunjët në fillim nuk kanë mundur ti konfiskojmë pasi i akuzuari ka kundërshtuar të mos i dorëzoj drunjët, në vend të ngjajrjës ka pasur edhe ... tjerë të cilët kanë thënë se nuk i lëshojnë drunjët për ti konfiskuar, në atë moment disa të rinjë sipas gjitha gjasave familjarët të të akuzuarit janë munduar ta bindin të akuzuarin t'i lëshojnë drunjët por i akuzuari nuk ka pranuar, pas kësaj policët kanë dashtë ta arrestojnë po i akuzuari ka rezistuar dhe nuk ka dashur të hy në veturë të policisë, nuk ka n' dëgjuar të shara nga ana e të akuzuarit.

Dëshmitari A. P. në dëshminë e tij ka deklaruar se ditkën konkrete ka qenë në patrullë me kolegen F. M., në rrugën që shpie për në fshatin ..., ku kanë takuar një traktor i cili kishte të ngarkuar drunjë, vozitësi në atë traktor ka qenë M.M., i njëjti nuk ka pasur dokumentacion të rregullt për drunjët të cilat ka qenë duke i bartur, kanë njoftuar stacionin policor për të ardhur një punëtor i ekonomisë së pyjeve, në vend ngjarje ka ardhur drejtori i APK-së G. S., i cili ka thënë se M. M. nuk paska dokumentacion të rregullt dhe drunjët duhen të konfiskohen, i akuzuari nuk është pajtuar që drunjët të konfiskohen dhe të dërgohen në depon e ekonomisë së pyjeve, ku të akuzuarit i kemi lënë hapësire të bindet dhe ta kthejë traktorin në drejtim të Kamenicës për ndryshe është i arrestuar, të akuzuarin personalisht e ka shoqëruar deri te vetura, i akuzuari nuk ka sharë, nuk e ka parë se ka goditur veturën e policisë, gjatë rrugës nuk e ka penguar.

Dëshmitari F. M. në dëshminë e tij ka deklaruar, më datën 30.09.2010 ka qenë në patrullë me kolegët A. P. dhe Y. Sh., kanë marr një informatë se në fshatin ... një traktor është duke transportuar drunjë, në hyrje të fshatit ... duke u kyçur në rrugën kryesore e kanë takuar një traktor me drunjë, i akuzuari ka thënë se drunjët janë të tij, aty ka pasur edhe disa persona tjerë, i akuzuari ka pasur disa dokumente të cilat nuk kanë qenë valide lidhur me transportimin e drunjëve, kanë thirrë në ekonominë e pyjeve, në vend të ngjarje ka ardhur drejtori i APK-së, i ka kontrolluar dokumentet dhe pas kontrollimit ka kontestuar se dokumentet nuk janë për rastin konkret, në mënyrën më të mirë të mundshme i kanë thënë se drunjët duhen të konfiskohen dhe të dërgohen në depon e ekonomisë së pyjeve, mirëpo i akuzuari ka refuzuar që ti konfiskohen drunjët nuk i ka zbatuar urdhëratë e tona, e kanë paralajmëruar se duhet të arrestohet për mos zbatimin e urdhrave, pas urdhrin për të hyrë i akuzuari në veturë të policisë ka kundërshtuar duke e goditur veturën zyrtare me shkelma dhe duke ofenduar në baza nacionale por unë

nuk e kuptoj gjuhën serbe, gjatë vënies së prangave ka kundërshtuar ti vihen prangat dhe ka qenë i pa sjellshëm, pasi është prangos dhe është futur në veturë të policisë nuk ka penguar më , institucionet e komunës nuk i ka respektuar.

Gjykata duke vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku , në përputhje me nenin 361 dhe nenin 8 të KPPRK-së, për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e akuzës ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Nga deklaratat e të gjithë dëshmitarëve u vërtetuan faktet se i akuzuari nuk i ka përfill urdhrat e policisë (për konfiskimin e drunjëve të cilat kanë qenë pa dokumentacion të rregullte) ka rezistuar gjatë prangosjes, ka fyer pjesëtarët e policisë ka kundërshtuar të hy në veturën e policisë duke e goditur veturën me këmbë me këto veprime i akuzuari ka penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Në bazë të këtyre provave u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ngarkohet i akuzuari e kjo u vërtetua nga provat të cilat u elaboruan më lartë, andaj këtyre provave gjykata u dha besim të plotë, pasi që këto prova përputheshin njëra me tjetrën, ndërsa nuk i dha besimin mbrojtëjes të të akuzuarit nga se e njëjta ishte jo bindëse, kontradiktore me provat e tjera të proceduara gjatë séancës për shqyrtimin kryesor dhe e destinuar me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, i akuzuari nuk mohoi se është ndalur ditën konkrete për kontroll nga zyrtarët policor dhe sipas drejtorit të AKP-së i njëjti nuk ka poseduar dokumentacion të rregullt për bartjen e drunjëve, mirëpo mohoi të ketë penguar zyrtarët policor në kryerjen e detyrave zyrtare, andaj në këtë drejtim mohimi i veprës penale nga ana e të akuzuarit në kuptim të mbrojtjes karshi provave dhe fakteve tjera të vërtetuara nga ana e gjykatës konsiderohen se janë irrelevant përkitazi me veprën dhe përgjegjësin penale të të akuzuarit.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 73, 74, të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që si rrethanë lehtësuese për te akuzuarin mori sjelljen korrekte në gjykatore, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale, mbajtës i familjes, si rrethanë rënduese gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, ndërkaq nuk ka gjetë rrethanë veqanërisht rënduese , andaj gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit me burg në kohëzgjatje prej 30 ditëve, do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar në neni 41, të KPRK-së, andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe në përgjithësi.

Vendimin mbi paushallin gjyqsor dhe shpenzimet procedurale gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë e në mbështetje të nenit 365 ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

më dt.11.08.2015 P.nr.44/2011

Procesmbajtësja

Gjyqtarja

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej
15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së
Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.